



A.nr.677/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës A.nr.677/2026, 18.05.2026, e parashtruar nga ankuesi Sh. P e deleguar më datë 22.06.2026, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokate F. B nga Vushtrria, kundër organit të punësimit: Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 26.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.677/2026, e datës 18.05.2026, e parashtruar nga ankuesi Sh.P, e deleguar më datë 22.06.2026.

II. Mbetet në fuqi Vendimi Ref:DS-330/2026 i datës 21.04.2026, i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi Shpëtim Prekazi, (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 20.04.2026, ka parashtruar kërkesë për kompensimin e shtesës në pagës në emër të përvojës së punës tek Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ndërsa më datë 21.04.2026, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka nxjerr Vendim Ref:DS-330/2026, me të cilin ka refuzuar kërkesën e ankuesit. Ankuesi kundër këtij vendimi, më datë 18.05.2026 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhje e Ankesave dhe Kontesteve ne Sekretariatin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Komisioni i Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datës 19.06.2026 ka nxjerr Vendim KA.nr.26/2026 me të cilin është shpall **Jo Kompetente** për të vendosur për ankesën e ankuesit, duke e bartur lëndën për shqyrtim dhe vendosjen te Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në kuptim të delegimit të kompetencës nga Komisioni i Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 22.06.2026 ka regjistruar rastin e palës ankuese nën shenjën A.nr.677/2026, dhe mbi këtë bazë do të trajtohet ankesa e datës 18.05.2026 e parashtruar nga ankuesi, pranë Komisionit për Zgjidhje e Ankesave dhe Kontesteve ne Sekretariatin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore në këtë lëndë administroi këto prova: Vendimin KA.nr.26/2026 të datës 19.06.2026 të Komisionit të Ankesave të SKGJK-së; Ankesën me numër 09/1026 të datës 18.05.2025 të ankuesit pranë Komisionit për Zgjidhje e Ankesave dhe Kontesteve në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimin Ref:DS-330/2026 të datës 21.04.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Kërkesën për kompensim e shtesës në pagë në emër të përvojës së punës e datës 20.04.2026 e parashtruar nga ankuesi tek Këshilli Gjyqësor i Kosovës; Autorizimin e datës 06.04.2026; Akt Emërimit të datës 15.12.2025.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesve është e pabazuar, **sepse:**

Nga shqyrtimi i provave të administruara rezulton se ankuesi sipas Akt Emërimit me Referencë:DS-1636/2025 të datës 15.12.2025 është i punësuar në pozitën *Zyrtar për Distribimin e Dokumenteve (Dorëzues)*, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri në kuadër të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Ndërsa në kuptim të shqyrtimit kompetencës lëndore, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 6 paragrafi 4, ku përcaktohet se : *“4. Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë”*, e duke marr për bazë këtë Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka nxjerr Rregullore Nr.03/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor, e Ndryshuar dhe Plotësuar me Rregulloren Nr.24/2024, me të cilin sipas nenit 28, neni 28 i rregullores bazë është ndryshuar dhe plotësuar sa i përket Klasifikimit të vendeve të punës për kategorinë Profesional 3, ku sipas, paragrafit 4 të nenit 28 të Rregullores Nr. 03/2025, është përcaktuar: *“4. Në kategorinë Profesional 3; Grupi J; Klasa J16, Koeficienti 5.3, bëjnë pjesë nëpunësit me emërtime të pozitës si vijon: 4.1. Recepcionist/Sekretariat dhe gjykatë; 4.2. Zyrtar Administrativ/Njësia; 13/14 4.3. Depoist/Sekretariat dhe gjykatë; 4.4. Zyrtar për Transport (Shofer)/Sekretariat/gjykatë/PZAP; 4.5. Zyrtar për Distribimin e Dokumenteve (dorëzues)/Sekretariat/gjykatë/PZAP”*, pra mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se pozita e ankuesit *Zyrtar për Distribimin e Dokumenteve (dorëzues)*, është klasifikuar si pozitë e kategorisë profesionale sipas klasës profesionale 3, pra sipas këtij përcaktimi ligjor, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është kompetent për të shqyrtuar çështjen e ankuesit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar pretendon se Vendimi Ref:DS-330/2026 i datës 21.04.2026, i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është nxjerr pa ndonjë bazë juridike për shkak që ekziston baza ligjore për kompensimin e shtesës për përvojën e punës për 0.5% sepse kjo është vendosur me Aktgjykimin KO79/23 të Gjykatës Kushtetuese. Kërkon të aprovohet në tërësi ankesa dhe të bëhet kompensimi nga 0.25% në 0.5% nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë e në vazhdimësi.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit referuar kompensimit lidhur me përvojën e punës, Kolegji i Këshillit i'u referua nenit 6 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *“6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë”*, dispozita këto të cilat i janë nënshtruar vlerësimit të

kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, më ç'rast, kjo e fundit, me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, në pikën II të dispozitivit ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ndërsa, në pjesën arsyetuese gjegjësisht në pikët 380 dhe 381 ka sqaruar: 380. *Gjykata ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) dhe paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me të drejtën në gëzimin paqësor të pronës dhe barazinë para ligjit. Kjo, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ndër të tjera, sepse (i) zbritja joproporcionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës është në kundërshtim të plotë me parimet kushtetuese, ligjore, parimet relevante ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe përtej cenimit të të drejtave respektive individuale, rezulton edhe në cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe vlerave të Republikës së Kosovës;....ndërsa (v) përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për të gjithë kategoritë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, kufizon të drejtat dhe liritë themelore të tyre, pa asnjë qëllim legjitim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 të Kushtetutës. 381. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna më sipër ndërlidhur dhe me efektin e Aktgjykimeve të Gjykatës, kjo e fundit (i) nuk do të shfuqizojë paragrafin 6 të nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, ndërsa (ii) do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. 382 Kjo sepse, lidhur me paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar që ndërlidhet me shtesën mbi pagën për përvojën e punës, Ligji i kontestuar në paragrafin 1 të nenit 45 të tij, ka shfuqizuar edhe Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, i cili përfshin nenin 18 (Shtesa mbi pagën për përvojën e punës) sipas të cilit, për çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike, nëpunësit civil sipas këtij ligji i takon e drejta shtesë në pagën bazë prej zero pikë pesë përqind (0,5%). Shpallja e pavlefshme e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar i kombinuar me faktin që Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë shfuqizohet gjithashtu përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar, do të rezultonte në zbrazëti ligjore, përkitazi më të drejtën për shtesa mbi pagën për përvojën e punës. Për pasojë, duke balancuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat dhe liritë themelore, Gjykata do të lë **në fuqi paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në periudhën prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, duke i përcaktuar detyrimin Kuvendit, që brenda kësaj periudhe të ndryshojë dhe/ose plotësojë paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi.** Në ndryshimin dhe/ose plotësimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Kuvendi duhet të ketë parasysh që efektet e ndryshimit/plotësimit të tij në kontekst të lartësisë së shtesës për përvojën e punës burojnë që nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi”.*

Andaj, duke qenë se Kuvendi i Kosovës brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese nuk ka bërë plotësim/ndryshimin e paragrafi 6 të nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Kolegji i Këshillit në mungesë të këtij rregullimi ligjor, nuk ka juridiksion ligjor që të detyroj institucionet publike të bëjnë kompensimin e përvojës së punës për zyrtarët publikë, andaj edhe Vendimi Ref:DS-330/2026 i datës 21.04.2026, i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është i ligjshëm, kështu që, pretendimi ankimor mbi rrethanat ekzistuese nuk ka mbështetje ligjore.

Theksuar si më sipër, Kolegji bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.677/2026, datë 26/06/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit ,Av.F.B;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në SKGJK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.